



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 169, Datë 03.11.2020

“MBI

**KËRKESËN E OST SH.A. PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR 2015-2025 TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërmat a) dhe e), nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 6, 7, 8, 10, 11, 12 dhe 13 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 15.09.2009 si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016. Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin fillestar nr. 109/9 prot., datë 15.10.2020, mbi shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020, dhe përditësimin e planit dhjetëvjeçar 2015 - 2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a, relacionet plotësues nr. 109/9-1 prot, datë 23.10.2020 dhe nr. 109/9-2 prot., datë 02/112020 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike.

Konstatoi:

- Bordi i ERE me Vendim nr. 115, datë, 09.07.2020 vendosi të fillojë procedurën për miratimin e planit të investimeve për vitin 2020, të shoqërisë OST sh.a. dhe shqyrtimin dhe miratimin e përditësimit të planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10 vjeçare 2015-2025.
- Në vijim të kësaj vendimarrje, ERE me shkresën nr. 1026 prot., datë 05.08.2020, ka njoftuar OST sha., dhe palët e interesit lidhur me vendimin e bordit si dhe ka bërë publikimin e planit të investimeve në faqen e internetit të ERE-s në rubrikën konsultime, në mënyrë që të bëhej i disponueshëm për opinione apo komente të mundshëm nga palët e interesuara.
- Vlera totale e investimeve parashikuar nga ana e OST sh.a. për tu realizuar ne vitin 2020 me fondet e veta në vlerën 3,640,853,152 Lekë, per tu disbursuar 1,251,052,952 Leke gjate vitit 2020.
- Investimet duhet të ishin paraqitur konform rregullores së miratuar me vendimin e bordit te ERE nr. 135, datë 06.09.2017 dhe të shoqëroheshin me analizat dhe relacionet përkatëse, ku më e rëndesishme është analiza kosto përfitim e cila do te krijonte mundësi për të vlerësuar leverdishmerine e projekteve të propozuara.
- Vlera totale e investimeve parashikuar nga OST sh.a. për tu realizuar ne vitin 2020, me financime të huaja është 1,418,857,364 lekë, (për t’u disbursuar nga kreditë) dhe investime për t’u financuar nga OST sh.a. si kosto lokale në vlerën 90,911,434 Lekë, si dhe grante 72,330,896.11 Lekë. Keto investime jane ne proces realizimi nga OST sh.a. dhe pergjate vitit 2020 pasi jane projekte te miratuara nga ERE ne vitet respektive. ERE ka dhene miratimet perkatese per keto investime/projekte ne miratimin e planeve te investimit te OST sh.a. ne vitet e mepareshme. OST sh.a. te vijoje me realizimin e tyre dhe te raportoje periodikisht ne ERE mbi ecurine e realizimit te tyre.

- Investimet e miratuara nga ERE ne vitet e mepareshem me financim nga fondet e shoqerise te cilat vijoje impelentimin e tyre pergjat vitit 2020 duhet te vijoje te kryen pasi jane te miratuar nga ERE ne vitet respektiv. Per investimet te cilat jane ne implementim te miratuara nga ERE ne vitet e mepareshme, OST sh.a. duhet te raportoje periodikisht ne ERE ne menyre qe te kryet monitorimi i ecurise se realizimit te tyre pergjate vitit 2020.
- Investimet e paraqitura per miratim per vitin 2020 me financim nga fondet e shoqerise parashikojne dhe investime ne infrastrukturen e fibres optike. Keto investime nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në: vendim nr. 194, datë 03.12.2019 mbi opinionin e ERES-s për kërkesën e OST sh.a., për dhënien në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike. Në këto kushte vlersojmë se keto investime nuk duhet te miratohen si pjesë e planit të investimeve te OST sh.a., për vitin 2020, sepse ato nuk duhet të mbulohen nëpërmjet tarifës së transmetimit, por nga të ardhurat e realizuara nga dhënia në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike per palet e treta, duke mos ndikuar në tarifën e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në kostot e lidhura me këtë shërbim ndaj klientëve fundorë.
- ERE konstatatoi mangësi në planin e investimeve për vitin 2020 të paraqitur për miratim nga OST sh.a., dhe me shkresën nr. 993/3 prot. datë 24.09. 2020 kërkoi nga OST sh.a. të plotësojë dhe të sqarojë mospërputhjet që evidentohen në aplikimin e bëre nga OST sh.a. në lidhje me planin e investimeve 2020.
- *“Rregullorja dhe procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”*. përcakton në nenin 8, pikat 2 dhe 4 ndër të tjera, se investimet e parashikuara duhet të shoqërohen me analizën kosto përfitim si dhe çdo investim i parashikuar duhet të shoqërohet me relacione shpjeguese. Analiza kosto përfitim është elementi kryesor për të vlerësuar leverdinë ekonomike të investimit të propozuar dhe mungesa e një analize të tillë, pengon ERE të vlerësojë leverdinë ekonomike të investimeve të propozuara.
- Vendimi i ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017, ka (3) tre vite që është në fuqi, kohë mëse e mjaftueshme per OST sh.a., për të hartuar çdo metodologji të kërkuar përfshirë dhe atë kosto- përfitim. OST sh.a. me shkresën nr. 4715/3 prot. datë 05.10.2020 duke mos paraqitur dokumentacion dhe informacion shtesë për sa kërkuar nga ERE me shkresat respektive, është u shprehur ndër të tjera se : *“...Në lidhje me analizën kosto përfitim ju sqarojmë dhe një herë se nga ana e OST sh.a. është e pamundur të kryhet analiza kosto përfitim për çdo investim të programuar pa patur një metodologji të përcaktuar qartë. OST sh.a. është në pritje të përfundimit të metodologjisë për CBA (Analiza Kosto/Përfitim), si nga ana e grupit të vet ashtu dhe nga përfundimi i studimit nga ana e ekspertëve të huaj të masterplanit të zhvillimit të rrjetit, pjesë e të cilit është dhe metodologjia e CBA...”*.
- Me shkresën sipërcituar, OST sh.a. ka përcjellë edhe vendimin nr. 11, datë 08.09.2020, të Këshillit mbikqyrës të OST sh.a., i cili ka miratuar ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të OST sh.a për vitin 2020 si dhe shkresën nr. 17037/1, datë 30.09.2020, ku janë miratuar ndryshimet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.
- OST sh.a., është një subjekt i licensuar nga ana e ERE-s dhe si i tillë duhet të zbatojë vendimet e ERE, përfshirë dhe vendimin nr. 135, datë 06.09.2017, dhe atë nr. 115, datë, 09.07.2020, pika 3, për depozitimin e informacionit të kërkuar.
- Investimet e planifikuara nga OST sh.a. për vitin 2020, duhet të kryhen sipas renditjes mbi prioritetin e tyre i cili ka si faktor përcaktues kriteret në zbatim të legjislacionit në fuqi me kosto më të ulët, me qëllim sigurinë e rrjetit, eficaenca në transmetimin e energjisë dhe ulja e humbjeve në

rrjet me qellim ruajtjen e stabilitetit tekniko-ekonomik të shoqërisë për vitin 2020, por duke siguruar që tarifat e përdorimit të rrjetit të transmetimit të mbeten të qëndrueshme në kohë.

- OST sh.a. ka ndërtuar një rrjet transmetimi i cili është sipas standarteve ndërkombëtare dhe ato të ENTSO-E dhe duhet të vijojë të mbajë qëndrueshmërinë e parametrave teknike mbështetur në këto standarte. Parimi për mbulimin e planit të investimeve me kosto më të ulët varet dhe nga mënyra e financimit të tyre dhe referuar eksperiencave më të mira rregullatore të OST-ve të vëndeve të tjera, janë investimet të cilat financohen me hua dhe jo ato të cilat financohen me kapitalet e shoqërisë.
- Balancimi i sistemit elektroenergjitik shqiptar është një ndër elementet kryesor për të siguruar qëndrueshmërinë e operimit të tij. Lidhur me detyrimet financiare të OST sh.a., ndaj KESH sh.a., për shërbimin e balancimit dhe detyrime të tjera të periudhave të mëparshme, në programin ekonomik të vitit 2020 nuk parashikohet asnjë element për shlyerjen e këtij detyrimi por parashikohen investime me fonde të vetë shoqërisë në vlera që arrijnë mbi 50 % të të gjithë të ardhurave të kompanisë, element i cili nuk është i mbështetur në VKM nr. 253, datë 24.04.2019, e cila për shoqërinë OST sh.a. nuk orienton kryerjen e investimeve me fondet e veta, ndyshe nga OSSH sh.a. si pasojë kapitalit negativ të trashëguar nga periudhat e mëparshme ushtrimore.
- Në lidhje me përditësimin e planit 10 vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me anë të shkresës nr. 1668/3, datë 22.04.2020, OST sh.a., ka dërguar planin sipas situatës aktuale, duke sqaruar se i vetmi tregues i ndryshuar, është viti i komisionimit për ato objekte të cilat janë në proces apo parashikohen të përfshihen në investime si pasojë e faktorëve të ndryshëm ku listohen procedurat e prokurimit, shpronësimet etj.
- Përditësimi i planit 10 vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit duhet të shoqërohej me argumenta lidhur me nevojën që këto investime paraqesin për rrjetin e transmetimit, të shoqëruara me shpjegime të cilat reflektojnë arsyet e pëshpejtimit të implementimit të tyre në vitin 2020, në kohën kur këto investime janë parashikuar për tu implementuar në periudhat e ardhshme, duke mos paraqitur informacion lidhur me ndryshimet në vlerat respektive për kryerjen e tyre, krahasuar me vlerat përkatëse në mbështetje të planit 10 vjeçar 2015-2025 të miratuar me anë të vendimit nr. 212, datë 28.12.2017 të Bordit të ERE.
- Sa parashtruar nga OST sh.a. vlerësohet se përditësimi i planit 10 vjeçar të investimeve është një element i rëndësishëm për zhvillimin e sistemit të transmetimit. Pavarësisht faktit se është në pritje të përfundimit të një masterplani të ri, kjo nuk pengon OST sh.a., që deri në daljen e tij, të rishikojë dhe të përditësojë planin ekzistues 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit.
- Plani i investimeve referuar Rregullores së miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, duhet të shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:
  1. Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e planit të investimeve
  2. Ndikimet e investimit në përmirësimin e performancës së operatorit
  3. Kostot, humbjet, burimi i financimit, periudhat e shlyerjes dhe çështje të tjera
  4. Analiza e përfitimit nga çdo projekt që justifikon kostot
  5. Skedulimi, studim fizibiliteti, impakti në mjedis, të drejtat pronësore
- Bazuar në gjithë sa parashtruar, rezulton si më poshtë:
  - OST sh.a. në paraqitjen e planit të investimeve të cilat do të prokurohen për vitin 2020, nuk ka dokumentuar konsultimin me palët e interesuara konform nenit 11, pika 4 dhe 6 të Rregullores së miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017.

- Nuk është zbatuar neni 8, pika 2 dhe pika 4 të Rregullores së miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, e cila përcakton ndër të tjera se investimet e parashikuara për 2020 duhet të shoqërohen me analizën kosto-përfitim si dhe çdo investim i parashikuar duhet të shoqërohet me relacione shpjeguese.
- Nuk është zbatuar pika 3 e vendimit nr. 115, datë, 09.07.2020, të bordit të ERE e cila përcakton se: Shoqëria OST sh.a., të depozitohet në ERE jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dokumentacionin e kërkuar sipas kushteve të parashikuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me vendimin nr. 135, datë 06.09.2017.
- OST sh.a. nuk ka zbatuar vendimin e bordit të ERE nr.194, datë 03.12.2019 mbi opinionin e ERE-s për kërkesën e OST sh.a., për dhënien në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike. Në pikën 1 gërma b) të këtij vendimi përcaktohet se: *“Kostot për realizimin e këtij aktiviteti të mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga kjo, duke mos ndikuar në tarifën e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në kostot e lidhura me këtë shërbim ndaj klientëve fundorë”*. Përfshirja e investimeve që lidhen me fibrën optike në planin e investimeve 2020, që mbulohen nga tarifa e OST sh.a, bie ndesh me vendimin e bordit të ERE nr. 194, datë 03.12.2019.
- OST sh.a nuk ka përcjellë në ERE përditësimin e planin 10 vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, sipas kritereve të përcaktuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017.
- OST sh.a. me shkresën nr. 4715/3 prot. datë 05.10.2020 nuk ka paraqitur dokumentacion dhe informacionet perkatese për sa kërkuar nga ERE me shkresën nr. 993/3 prot. datë 24.09.2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Rrëzimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve me fondet e shoqërisë për vitin 2020, me vlere totale të parashikuara prej 3,640,853,152 Leke.
2. OST sh.a., të përcjellë në ERE brënda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, argumenta specifike për vlerat e zërave të përcaktuara gjatë vitit 2019, të cilat paraqiten sërish në vitin 2020 dhe ndryshojnë në vlera nga ato të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 228, datë 20.12.2019.
3. OST sh.a., të përcjellë në ERE brënda datës 31.12.2020 planin e rishikuar 10 vjeçar 2015- 2020 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.
4. OST sh.a. të raportojë në mënyrë periodike në ERE lidhur me investimet/projektet në implementim, të miratuara nga ERE në vitet e kaluara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 169, Datë 03.11.2020

“MBI

**KËRKESËN E OST SH.A. PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN  
2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR 2015-2025 TË ZHVILLIMIT TË  
RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SH.A.”**

Antarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

\_\_\_\_\_

Adriatik Bego

\_\_\_\_\_

Erjola Sadushi

\_\_\_\_\_

Maksim Shuli

\_\_\_\_\_

Raimonda Islamaj

\_\_\_\_\_

